

VENDIM
Nr.595, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA BALLAGAT, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Ballagat, të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ballagat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULARI PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Mbeshtetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Komuna: **Ballagat**

Fusha e përdorimit të pronës: pyll, kullotë etj.

Nr. Rend.	Nr. Inv.	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	22	Gramitur Hyzgjakaj	Pylli i Gjyshajt	3/a	Lp + D.zjarri	18	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P	
2	23	“	Pylli i Gjyshajt	4/a	Lp + D.zjarri	6.25	“	“	“	
3	24	“	Fargeza	5/a	Lp + D.zjarri	42.5	“	“	“	
4	25	“	Mali i Dardhas	6/c	Lp + D.zjarri	10	“	“	“	
5	26	“	Mali i Dardhas	6/a	Lp + D.zjarri	11.5	“	“	“	
6	27	“	Mali i Dardhas	6/b	Boshe	29	“	“	“	
7	28	“	Teqa e Matjanit	11	Kullote	48	“	“	“	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Ballagat
nr.1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
22-26	Pyll	Në pronësi
27	Boshe	Në pronësi
28	Kullotë	Në pronësi